

AKT – THEMELIMI

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR " FRESH FRUITS & VEGETABLES" SHPK

Sot ne daten 08.04.2024 , ne te nenshkruarit :

1.Kujtim Hoti, i datelindjes 14.12.1971 , lindur ne Qerret, me banim ne Durrës, i pajisur me pasaporten nr.BC4367540 dhe nr.personal H11214113W,

2.Saimir Aliaj, i datelindjes 06.04.1988 , lindur ne Durrës, me banim ne Durrës, i pajisur me leternjoftim nr.036755847 dhe nr.personal I80406083A,

Ne baze te ligjit nr.9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" dhe ligjit nr.9723 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", kemi vendosur te themelojme shoqerine me pergjegjesi te kufizuar "**FRESH FRUITS & VEGETABLES**" SHPK.

NENI 1

EMERTIMI I SHOQERISE

Shoqeria do te quhet "**FRESH FRUITS & VEGETABLES**" SHPK dhe eshte person juridik shqiptar. Veprimtaria e saj rregullohet sipas neneve te ketij statuti dhe Ligjit 9901 date 14.04.2008, si edhe Ligjit per QKR-se .

NENI 2

SELIA E SHOQERISE

Shoqeria do te kete seline e saj ne Durres, L.13, Rr"Pavarsia", ZK 8548, Nr.P 1/52, Vol.30, fq 19. Shoqeria mund te krijojte filiale, zyra perfaqesimi, ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

NENI 3

OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE

Shoqeria do te kete si objekt te veprimtarise se saj:

Tregti produkte ushqimore te fresketa dhe te ngrira, fruta, perime, fruta egzotike, agrume, erza, etj. dhe import eksport i ketyre produkteve.

Shoqeria sipas nevojave te aktivitetit ka te drejten e ushtrimit te çdo aktiviteti te ligjshem, te lejueshem per formen e shoqerise, e cila nuk ndalohet me ligj (sipas nenit 7 te Ligjit Nr.9901, dt 14-04-08).

NENI 4

KAPITALI I SHOQERISE

Kapitali i shoqerise "**FRESH FRUITS & VEGETABLES**" SHPK eshte 100.000 Leke .

Ky kapital eshte i ndare ne 2 kuota.

Kontributi i ortakeve eshte i ndare si vijon

1. Kujtim Hoti, zoteron 50 % te kapitalit .

2. Saimir Aliaj , zoteron 50 % te kapitalit.

NENI 5

KOHEZGJATJA E SHOQERISE

Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine e saj per nje periudhe kohore te papercaktuar.

NENI 6

ORGANET E SHOQERISE

-Asambleja e pergjithshme.

-Administratoret.

ASAMBLEJA E PERGJITHSHME

Asambleja e pergjithshme eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet e meposhtme:

-Percaktimin e politikave tregtare te shoqerise.

-Ndryshimin e statutit.

-Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve.

-Emerimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe te ekspereve kontabel te autorizuar.

-Percaktimin e shperblimeve per administratorin, likuiduesin dhe ekspertin kontabel.

-Mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise.

-Zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit.

-Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre.

-Perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve.

-Riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

-Miratimin e rregullave proceduriale te mbledhjeve te asamblese.

-Çeshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.

ADMINISTRATORET

Administrator i shoqerise do te jete zoti Saimir Aliaj, i datelindjes 06.04.1988, lindur ne Durrës, me banim ne Durrës, i pajisur me leternjoftim nr.036755847 dhe nr.personal I80406083A, i cili emerohet per nje periudhe 5-vjeçare, me te drejte riparteritje te ketij afati.

Administratori mund te shkarkohet ne çdo moment nga asambleja, me shumicë të thjeshte te votave, me kusht që në mbledhje të marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30% të kuotave.

Statuti apo marreveshje te tjera nuk mund te perjashtojne apo kufizojne kete te drejte.

NENI 7

Shpërndarja e fitimit vjetor të shoqërisë

Pjesa e fitimit që i takon secilit ortak nga vlera e fitimit vjetor të deklaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë, vendoset të shpërndahet nga asambleja e përgjithshme.

Asambleja e Përgjithshme ka kompetencë t'u shpërndajë ortakëve pjesën e fitimit në raport me vlerën e kapitalit të regjistruar, që kuotat e secilit ortak përfaqësojnë.

Po ashtu, Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë që një pjesë e fitimit vjetor të mos u shpërndahet ortakëve, por këto shuma të përdoren për zmadhimin e kapitalit fillestar apo për qëllime të tjera, të cilat ajo i konsideron të dobishme për shoqërinë.

NENI 8

Prishja e shoqërisë.

Prishja e shoqërisë

Shoqëria priset :

- a) kur mbaron kohezgjatja e parashikuar në themelimin e saj,
- b) me vendim të asamblesë së përgjithshme,
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit,
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723 datë 3.5.2007 për "QKR",
- d) me vendim të gjykatës,
- dh) për arsye të tjera, të parashikuara në statut.

NENI 9

Likuidimi i shoqërisë.

Në rast të likuidimit të shoqërisë, Asambleja e Përgjithshme emëron një likuidator, i cili administron shoqërinë deri në mbylljen e procesit të likuidimit.

Me vendimin e posaçëm të Asamblesë së Përgjithshme, të marrë me shumicë të kualifikuar, pasi janë shlyer detyrimet ligjore ndaj kreditorëve të shoqërisë, likuidatori shpërndan pjesën e mbetur të pasurisë së shoqërisë ndërmjet ortakëve. Kjo shpërndarje e fundit bëhet në raport me vlerën e kapitalit të regjistruar, që kuotat e secilit ortak përfaqësojnë.

Likuiduesit duhet të ftojnë kreditorët për të depozituar pretendimet e tyre për prishjen e saj. Shoqëria e publikon dy herë këtë njoftim, me një interval prej 30 ditësh, në faqen e saj të internetit, si dhe në faqen e internetit të Qendrës

Kombëtare të Biznesit. Në njoftim duhet deklaruar se pretendimet duhet të depozitohen brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të fundit.


NENI 10

Përfundimi i likuidimit

Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetura, likuiduesi e njofton Qendrën Kombëtare të Biznesit për përfundimin e likuidimit dhe kërkon çregjistrimin e shoqërisë
Veprimtaria e likuiduesit nuk mund të kundërshtohet pas çregjistrimit të shoqërisë nga Qendra Kombëtare e Biznesit.

ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE " FRESH FRUITS & VEGETABLES" SHPK

1.Kujtim Hoti

Kujtim Hoti


2.Saimir Aliaj

Saimir Aliaj
